

V E N D I M
Nr. 296, datë 27.6.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-VELIPOJË**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-Velipojë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 1430 m² tokë/arë, 20 rrënjë hardhi, 2 rrënjë fiq, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 315 425 (një milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 132 000 (njëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh.

5. Fondi prej 1 447 425 (një milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.7.2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU: SHKODËR
KOMUNA: BËRDICË

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor Shkodër-Velipojë

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-6), dru frutorë

Nr	Pronarët			Nr. pikët	Nr. i parce lës	Sip. Fakt. m ²	Çmi mi Lek /m ²	Vlera në lekë	Fiq cop ë	Vlera Lekë	Rrus h copë	Vlera lekë	Vlera e plotë në lekë
	Emër	Atësi	Mbiemër										
1	Brahim	Arif	Koburja	13	101/1	101	900						90900
2	Prec	Ndoc	Cerjani	14-15	135/1	378	900						340200
3	Hysni	Metush	Meti	18-20	135/2	637	900						573300
4	Rrok	Mark	Bituku	20-22	531	162	900						145800

5	File	Lluke	Jaku	60-61	484/9	53	900						47700
6	Jac	Mark	Jaku	60-61	484/10	99	900		2	8283	20	20142	117525
	SHU MA												1315425

Shpenzime procedurale: 132 000 lekë.